



Protokoli i shkurtë i mbledhjes së Kuvendit të gjashtë të rregullt të BISHZ-së më 15.11.2003

Vendi: Qendra Shkollore Formazione, Freiburgstrasse 139c, 3008 Bern

Data: E shtunë, 15 nëntor 2003 / 14.00-17.00

Protokoli: Ahmet Xhigoli (sekretar)

Pjesëmarrës: Rreth 30

Pikat e rendit të ditës:

1. Hapja e Kuvendit dhe përshëndetja e të pranishmëve
2. Paraqitja e raportit të punës së BISHZ-së për periudhën 30.11.02 - 14.11.03
3. Vështrim i shkurtë i punës gjashtëvjeçare të BISHZ-së
4. Zgjedhja e kryesisë dhe komisionit të konrtoll-revizionit për periudhën 2003-2005
5. Mobilizimi i BISHZ-së në përkrahjen e aksionit “Familja-ndihmon-Familjën“
6. Ndarja e mirënjohjeve
7. Të ndryshme

1. Përshëndetja e të pranishmëve – hapja e Kuvendit

Sipas rendit të ditës të përshkruar në ftesë, inxh. i dipl. Sinollah Shehu, nënkryetar, bëri hapjen e Kuvendit të gjashtë të rregullt dhe i përshëndeti të gjithë të pranishmit si dhe në veçanti musafirët, Profesorin Astrit Leka, anëtar nderi i BISHZ-së dhe Zotëri Rexhep Rifati, gazetar për “Fakti” – n;

Të ftuar ishin edhe ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Bern, Zotëri Leontier Quqi; ambasadori Zotëri Vladimir Thanati nga Misioni i Republikës së Shqipërisë pranë selisë së OKB në Gjenevë; sekretari i Ambasadës së Maqedonisë në Bern, Zotëri Leonard Marku dhe Nazif Xhaferi, diplomat nga Maqedonia pranë selisë së OKB në Gjenevë, të cilët për shkaqe të arsyeshme nuk kanë mund të vijnë. Në vazhdim, z. Shehu lexoi rendin e ditës dhe e luti kryetarin e BISHZ-së, dr. Xhevat Salihu të bën paraqitjen e raportit të punës njëvjeçare të Shoqatës.



2. Raporti vjetor i BISHZ-së prej 30.11.2002 deri më 14.11.2003

Dokumenti "Raporti vjetor i BISHZ-së prej 30.11.2003 deri më 14.11.2003 u është shpërndarë të pranishëmve.

Aprovimi i raportit të punës për periudhën 30.11.02 – 14.11.03

Dr. Xhevat Salihu përmes folive paraqiti raportin e aktivitetit të BISHZ-së për periudhën 30.11.02 – 14.11.03. Pas referimit të kryetarit, pyetje nuk pati. Me këtë përfundoi kjo pikë dhe raporti u aprovua në tërësi.

3. Vështrim i shkurtë i punës gjashtëvjeçare të BISHZ-së

Në këtë pikë, zotëri A. Xhigoli, sekretar, së pari u shprehi përshëndetjet e singerta për pjesëmarrje me rastin e gjashtëvjetorit të Bashkimit të intelektualëve shqiptarë në Zvicër me seli në Bernë, të gjithë të pranishëmve. Më tutje ai theksoi që shkas i këtij tubimi të sotëm është mbledhja e Kuvendit të gjashtë ku me këtë po përmbillet puna gjashtëvjeçare e shoqatës tonë.

Në vazhdim, ai, shkurtimisht bëri një njoftim për rrugën e formimit të kësaj Shoqate dhe për rezultatet e punës gjatë kësaj periudhe. Po ashtu z. Xhigoli theksoi që për këto gjashtë vjet të kaluara, në këtë shoqatë janë bërë përpjekje dhe vetmohime të mëdha dhe janë arritur rezultate të konsiderueshme si dhe në masë të madhe janë realizuar detyrat e parashtruara në programin e saj.

Z. Xhigoli i falenderoj të gjithë ata të cilët në çfarëdo mënyre kanë dhënë ndihmesë në mbarëvajtjen e punës së BISHZ-së dhe posaçërisht i falënderoj të gjithë ambasadorët shqiptarë pranë Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Bernë dhe Misionit të saj pranë OKB-së në Gjenevë, të gjithë përfaqësuesit e Republikës së Kosovës në Zvicër, të gjithë përfaqësuesit shqiptarë pranë Ambasadës së Republikës së Maqedonisë në Benë dhe Misionit të saj pranë OKB-së në Gjenevë, pra, të gjithëve, të cilët e kanë përkrah mbarëvajtjen e punës së BISHZ-së prej themelimit e deri më sot dhe shpersoj që një përkrahje të tillë do të kemi nga insitucionet e përmendura edhe në të ardhmen. Dhe në fund po ashtu e falënderoj gazetarin Zot. Rexhep Rifati për përkrahjen dhe afrimin e vlerave të BISHZ-së në mjetet e informimit.

4. Zgjedhja e kryesisë dhe komisionit të konrtoll-revizionit për periudhën 2003.2005

Zgjedhja e kryesisë për periudhën 2003.2005

Në pikën e katërt të rendit të ditës janë dhënë disa rekomandime për zgjedhje. Pas përfundimit të diskutimeve me drejtë vote është vendosur, që Kryesia e re do të jetë në përbërje prej 15 anëtarëve.

Anëtarët e rinjë të zgjedhur në Kuvend janë: Xhevat Salihu, Sinollah Shehu, Ahmet Xhigoli, Ismet Rexhaj, Imer Cacakaj, Skender Jusufi, Adnan Mehmeti, Ramiz Shabani, Artan Bajrami, Hana Bajrami, Agim Gerbavci, Florin Thaçi, Shkumbin Rmoku, Lokman Beqiri, hapur.

Njëzërit për Kryetar, Nënkyetar, Sekretar dhe Arkëtar janë zgjedhur:

- Kryetar: Ahmet Xhigoli
- Nënkyetar: Sinollah Shehu
- Sekretar: Abas Fejzullahi



- Arkëtar: Ismet Rexhaj

Zgjedhja e komisionit të kontroll-revizionit për periudhën 2003-2005

Komisioni i revizionit përbëhet prej tre anëtarëve.

U zgjodhën:

- Adnan Mehmeti
- Ramiz Shabani
- Llokman Beqiri

Dr. Salihu në emër të Kryesisë i falendëroi anëtarët e kryesisë së vjetër dhe administartorët e Shoqatës për punën e tyre të mirë në periudhën 2001-2003.

5. Mobilizimi i BISHZ-së në përkrahjen e aksionit “Familja-ndihmon-Familjën”

Në këtë pikë, zotëri Abas Fejzullahi, paraqiti të dhënat lidhur me aktivitetin e deritashëm të shoqatës “Familja-ndihmon-Familjën” në Kosovë dhe shprehi mendimin se sot në Kosovë gjendja materiale është po ashtu shumë e rëndë dhe është mirë që BISHZ-ja të përkrah këtë akcion i cili do të filloj së shpejti edhe në Zvicër. Iniciativa u përkrah nga të gjithë të pranishmit me vërejtje që ky akcion “Familja-ndihmon-Familjën” të mos kufizohet vetëm për territorin e Kosovës por të shtrihet në hapsirën gjithë-shqiptare, pra edhe në Shqipëri, Maqedoni, Kosovë Lindore, Mali Zi dhe në trevat tjera shqiptare. U muar qëndrim që kjo të konkretizohet në mbledhjet e ardhshme të kryesisë.

4. Ndarja e mirënjohjeve

Në këtë pikë të rendit të ditës, kryetari, dr. Salihu bëri ndarjën e një lavdate për z. Xhigoli dhe tri mirënjohje për intelektualët dhe veprimtarët të cilët e kanë ndihmuar punën e Shoqatës dhe çështjen kombëtare në tërësi dhe një mirënjohje për Qytetin e KUKËSIT për kontributë të veçantë të dhënë Kosovës dhe popullit të saj në periudhën 1998-99. Lista e lavdatës/mirënjohjeve të dhëna në Kuvendin e gjashtë është:

Lavdatë/ Mirënjohje

1. Ahmet Xhigoli (sekretar i BISHZ-së në periudhën 2001-2003)
2. Astrit Leka (anëtar nderi i BISHZ-së)
3. Abas Fejzullahi (këshilltar)
4. Skender Jusufi (këshilltar)
5. Qytetit të KUKËSIT, Shqipëri

Për secilin kandidat/institucion, kryetari z. Salihu para të pranishmëve e ka bërë leximin e përmbajtjes së lavdatës/mirënjohjes.



6. Të ndryshme

- Prof. Astrit Leka bëri një vështrim të shkurtë lidhur me gjendjen e ngritjes së Bustave të Gjegj Kastrioti-Skender Beu, dhe Nënës Terezë në qendra të ndryshme Europiane dhe më gjërë. Po ashtu Zot. Leka i njohtoi të pranishmit lidhur me një dokument-fletushkë të cilin e ka përgatitur në frëngjisht dhe në shqip, lidhur me një profil të shkurtë të historisë së shqiptarëve për të haujt.

Pas përfundimit të kësaj nënpike nën pikën e rendit të ditës “të ndryshme“ nuk pati ndonjë nënpikë tjetër konkrete. Pastaj, kryetari dr. Salihu e mbylli këtë Kuvend duke i ftuar të pranishmit në një koktej të cilin e organizoi kryesia e BISHZ-së.

Mbledhja e Kuvendit përfundoi në ora 17:00.

Pas koktejit në Qendrën shkollore Formazione në Bernë, kryesia e vjetër e BISHZ-së në bazë të njohtimeve të mëhershme po ashtu organizoi një darkë të përbashkët me anëtarët e kryesisë së vjetër/re dhe të familjeve të tyre si dhe mysafirëve të fëtuar në restorantin “La Gioja“ në Bernë, të pronarit Zot. Hysni Jemini.

Udhëhqësi i protokolit: dr.sc. Ahmet Xhigoli

Bellach, 17 nëntor 2003